

Vendim nr. 216, datë 25.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 25.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (P) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES:

PAVLLO VOJKOLLARI, ELENi VOJKOLLARI,
përfaqësuar nga avokati Myrteza Myftari, me prokurë të
posaçme.
LEONORA ROFI, përfaqësuar nga avokatët Myrteza
Myftari dhe Erdi Prifti, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI:

**Shfuqizimi i vendimeve nr. 717/30-2023-2257, datë
22.05.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të
Përgjithshëm; nr. 00-2025-1773, datë 20.11.2025 të
Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të
papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së
Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit
të Juridiksionit të Përgjithshëm.**

BAZA LIGJORE:

**Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1,
shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së
Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës
Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë
10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i
ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Pavllo Vojkollari dhe Eleni Vojkollari (bashkëshortë), në cilësinë e pronarëve të një objekti me sipërfaqe 40 m² (e përbërë nga dy seksione 21 m² dhe 19 m²), të ndodhur në Tiranë, në datën 18.01.2019 kanë lidhur një kontratë qiraje me shtetasen/kërkuesen tjetër Leonora Rofi, me afat deri në datën 25.01.2025. Gjatë kohës që kërkuesja Leonora Rofi po ushtronte aktivitetin privat në objektin e marrë sipas kontratës së qirasë, i është kërkuar nga shtetasi P.D., i prezantuar si pronari i objektit, për ta liruar, pasi po e posedonte në mënyrë të padrejtë. Në këto rrethana, kërkuesja Leonora Rofi është vënë në dijeni se kërkuesit për të njëjtin objektin kishin kryer më parë disa veprime juridike te noteri. Konkretisht, në datën 24.01.2017, mes kërkuesve dhe shtetasit P.D. është lidhur një kontratë premtimshitjeje, për një ndërtesë 21 m² në vlerën 22.000 euro; në datën 24.07.2017 është lëshuar një deklaratë noteriale për likuidimin e vlerës 22.000 euro dhe se shtetasi P.D. u detyrohej kërkuesve edhe 68.000 euro për pjesën në proces legalizimi; në datën 31.10.2017 është lëshuar deklaratë noteriale, sipas së cilës kërkuesit kanë hequr dorë nga legalizimi në favor të shtetasit P.D.; në datën 31.10.2017 është lëshuar deklaratë noteriale, ku përcaktohej çmimi në total 90.000 euro për të dyja pasuritë (21 m² dhe pjesa në legalizim); në datën 24.01.2019 është lidhur kontrata e shitjes, në emër të shtetasit P.D.

2. Në këto rrethana, të tre kërkuesit i janë drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kallëzim penal ndaj noterëve dhe shtetasit P.D., që kishin kryer veprimet, duke i akuzuar ata për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 143, paragrafi i tretë, dhe 186, paragrafi i parë, të Kodit Penal (KP). Kallëzimet e tyre janë bashkuar në një të vetme me nr. 7386, datë 01.10.2019. Pas kryerjes së veprimeve hetimeve, prokuroria i është drejtuar gjykatës duke kërkuar pushimin e procedimit penal nr. 7386, datë 01.10.2019, pasi palët kishin kryer me vullnetin e tyre të lirë veprimet juridike dhe se fakti i pretenduar nuk parashikohej si vepër penale. Sipas prokurorisë, problematikat e çështjes janë të natyrës juridiko-civile, sepse palët nëpërmjet veprimeve juridike kanë shfaqur në mënyrë të ligjshme vullnetin e tyre në krijimin e të drejtave dhe detyrimeve me akte të shkruara, me kontratat e shitjes së pasurisë së paluajtshme ose premtimin e këtij veprimi, ashtu edhe në rastin e prokurës së posaçme të lëshuar nga kërkuesit Pavllo Vojkollari dhe Eleni Vojkollari. Sipas prokurorisë, noterët në çdo

rast në aktet përkatëse kanë pasqyruar vullnetin e secilës palë të përfshirë në marrëdhënie. Kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin e prokurorit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin, nr. 402 akti, datë 16.07.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal duke e vlerësuar të drejtë qëndrimin e tij. Për kërkuesen Leonora Rofi ka arsyetuar se jemi përpara zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qirasë. Ndërsa për kallëzimin e dy kërkuesve të tjerë noterët kanë kryer veprime të parashikuara nga ligji duke u bazuar në vullnetin e lirë të palëve. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se për të njëjtat fakte kërkuesit kanë paraqitur edhe më parë kallëzim penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës së noterëve për falsifikimin e prokurës së posaçme. Edhe në atë rast, gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. 530 regj., datë 05.03.2020, ka vendosur rrëzimin e ankimit kundër vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal, duke u ndodhur përpara gjësë së gjykuar.

4. Pas ankimit të kërkuesve Pavllo Vojkollari dhe Eleni Vojkollari (Leonora Rofi nuk ka paraqitur ankim), Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 717/30-2023-2257, datë 22.05.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 402 akti, datë 16.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas rekurseve të ushtruara nga kërkuesit Pavllo Vojkollari, Eleni Vojkollari dhe Leonora Rofi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1773, datë 20.11.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve, pasi shkaqet e paraqitura nuk i referoheshin nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Kërkuesit në datën 19.03.2026 i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual. Kërkesa është regjistruar në datën 03.04.2026, pas plotësimit të dokumenteve sipas nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës.

II

Pretendimet e kërkuesve

6. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmblodhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në aspektet e mëposhtme:

6.1.1. *Mungesa e hetimeve të plota*, pasi gjatë hetimeve nuk është urdhëruar kryerja e akteve të ekspertimit për nënshkrimet në prokurat e lëshuara, nuk është hetuar për veprën penale të vjedhjes që i është bërë kërkueses Leonora Rofi dhe nuk është hetuar për mënyrës e marrjes në posedim të objektit nga shtetasi P.D.

6.1.2. *E drejta aksesit dhe e drejta për t'u dëgjuar*, pasi gjykata e apelit nuk e ka njoftuar kërkuesen Leonora Rofi për gjykimin e çështjes në atë gjykatë, megjithëse edhe ajo ishte palë në procesin penal.

6.1.3. *Parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit, si dhe parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë marrë parasysh pretendimet se prokura e posaçme ndaj shtetasit P.D. ka qenë e falsifikuar.

6.1.4. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi megjithëse pretendimet për falsifikimin e prokurës janë parashtruar në rekurs, Gjykata e Lartë nuk është shprehur për të.

6.2. *E drejta e pronës, e garantuar në nenin 41 të Kushtetutës*, pasi prona është tjetërsuar në kundërshtim me ligjin.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuësin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

9. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon të ndalet në analizën e kriterit të legjitimitimit *ratione personae*, për të cilin, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji evidenton se kërkuësi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal, të përmbyllur në të tria shkallët e gjyqësorit, që ka

vendosur për pushimin e procedimit penal, ku ata kanë qenë kallëzues, me pretendimin se iu është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të mungesës së një hetimi efektiv, së drejtës për t'u dëgjuar dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kërkuesit gjithashtu kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës. Nga pikëpamja procedurale dy kërkuesit Pavllo Vojkollari dhe Eleni Vojkollari e justifikojnë interesin e tyre në çështjen e parashtruar, pasi kanë qenë kallëzues në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara. Ndërsa kërkuesja tjetër Leonora Rofi, megjithëse ka qenë kallëzuese në prokurori dhe e ka kundërshtuar vendimin e prokurorit në shkallën e parë, nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezulton se nuk ka ushtruar ankim në gjykatën e apelit. Në këtë drejtim, kërkuesja Leonora Rofi për efekt të gjykimit kushtetues nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, prandaj pretendimi i saj për faktin se gjykata e apelit nuk e ka njoftuar, nuk mund të merret në shqyrtim.

10. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitetit *ratione personae*, për të dy kërkuesit e tjerë, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individ mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesit duhet të justifikojnë interesin kushtetues dhe faktin se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real. Nisur nga kjo, duke mbajtur parasysh faktet dhe natyrën e kësaj çështjeje, në vijim do të verifikohet, fillimisht, se cila e drejtë kushtetuese substanciale e kërkuesve vihet në diskutim në këtë rast dhe, në vijim, nëse vendimet e kundërshtuara të gjykatave janë ato që kanë ose mund të sjellin pasojat negative për atë të drejtë. Në këtë mënyrë do të vlerësohet nëse kërkuesit kanë statusin e viktimës në raport me vendimet gjyqësore të kundërshtuara, e për rrjedhojë, nëse ata legjitimohen *ratione personae* për të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

11. Në rastin konkret, Kolegji evidenton se procesi gjyqësor objekt i ankimit kushtetues individual ka të bëjë, në thelb, me kundërshtimin e vendimit të pushimit të procedimit penal për kallëzimin e bërë nga kërkuesit, për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafi i tretë, dhe 186, paragrafi i parë, të KP-së. Vendimi i pushimit të procedimit penal është kundërshtuar nga kërkuesit. Të tria gjykatat e zakonshme e kanë konsideruar të drejtë vendimmarrjen e prokurorit, duke vlerësuar se vendimi ishte i argumentuar dhe se në asnjë rast nuk është vënë në diskutim përkatësia e së drejtës së pronës, sepse veprimet juridike të kundërshtuara kanë natyrë juridike civile dhe nuk paraqesin problematika të aspektit penal.

12. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se ndonëse në themel pretendimet e kërkuesve kanë të bëjnë kryesisht me të drejtën e pronës, procesi penal duket se nuk është rruga e vetme për rregullimin e pasojave materiale që ata synojnë, përveçse ky proces as nuk i kushtëzon në

përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave substanciale (civile), që ata pretendojnë se i janë shkelur. Nën këtë këndvështrim, procesi gjyqësor penal i kundërshtuar në gjykimin kushtetues nuk ndikon dhe as kushtëzon të drejtat civile që lidhen me mosmarrëveshje për të drejtën e pronës dhe, në këtë drejtim, kërkuessit nuk plotësojnë aspektin substancial të legjitimitetit *ratione personae*.

13. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.